



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 2, datë 10.03.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:12

Data e mbajtjes së mbledhjes : 10.03.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përsëndetje të gjithëve!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje, siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria, do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë.

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave.

Dorina Milja: Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

39 Këshilltarë në sallë.

V.O... Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltarja Ana Dhamo dhe Edlira Shemsi. Gjithsej gjatë mbledhjes 41 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me leximin e rendit të ditës

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN SHKURT 2025
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA Durrës, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE RRASHBULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA Durrës
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQINDMIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT TË PASHPENZUARA NË VITIN 2024, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2025
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDREQJES SË GABIMIT ME KARAKTER MATERIAL NË VKB-NË NR. 116, DATË 24.12.2024 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025”
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Atëhere a ka ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës ?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?Nuk ka

Abstenim?.....Nuk ka

Atëhere me 39 vota pro kalon rendi i ditës.

- Kalojmë **në pikën 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doci: Mirëdita!

Komisioni jonë u mbledh dhe vendosi që pika 1 t'i kalojë Këshillit Bashkiak për miratim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zonja Doçi.

Komente në lidhje me pikën 1 keni?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?.....Nuk ka.

Atëhere me 39 vota pro miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Musaraj .

Joniada Musaraj: Atëhere përshëndetje të gjithëve!

Komisioni i miratoi me shumicën e votave pikën 2 dhe propozon për miratim sot në Këshill, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Atëhere Komisioni i Pronave Publike e kaloi për miratim në Këshillin Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 2, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës ?

Kundra?.....

Abstenim?.....Nuk ka.

Atëhere me 39 vota pro miratohet.

- Kalojmë në **pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj .

Joniada Musaraj: Atëhere dhe pikën 3 Komisioni jonë e kaloi sot për miratim në Këshill, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit, Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe pikën 3 komisioni e kalon në votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit Të Tokës zonja Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje!

Edhe komisioni jonë e kaloj për miratim në Këshill, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Atëhere në lidhje me pikën 3, kemi ndonjë koment nga ana e këshillatrëve ?

Po zoti Myshketa, pastaj zoti Muka.

Jonuz Myshketa: Përshëndetje të gjithëve!

Në radhë të parë për rikonstrukcionin e rrugës Ishëm okey duhet bërë, por shoh që vlera nuk reflekton aspak vlerën reale të tregut. Ajo zonë dikur ka pasur një rrugë kapërciorisht të pakalueshme, është rindërtuar e gjithë zona para vitit 2013, e cila gjithë zona mori një vlerë realisht e them me çmime konkurrese dhe në qytet. Më duket, unë e kuptoj që është marrë harta e vlerës së tokës si bazë ku shumica është tokë bujqësore, por po të bëhet një rrugëtim shumë i thjeshtë në atë zonë, nuk e respekton absolutisht atë vlerë kur mund të jenë vlera shumë të larta dhe kërkoj një dëmshpërblim të drejtë dhe nuk jam kundër investimit, sepse ai i shërben komunitetit jo vetëm atyre banorëve që i merret dhe shpronësohet, por më duket e papranueshme vlera që është marrë parasysh tek kjo zonë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Zoti Muka.

Ardian Muka: Të njëjtën gjë do thoja dhe unë nga ana e bashkisë është marrë për bazë thjesht referenca që vjen, pra për tokën bujqësore, apo është marrë për bazë çmimi i trasaksioneve për tre muajt e fundit, kuptohet që me 4 milion lekë të vjetra të mbyllësh shpronësimin në gjithë atë zonë, mua më duket e pamundur. Nuk dua që të rikthehem ndoshta në një moment të dytë, nuk po flas për gabim kësaj radhe, por normalisht duhet parë më me objektivizëm. Çmimi nuk është çmimi real, çmimi i tokës flasim për atë zonë. Dhe ndofta siç bëme operacionin kur folëm për reabilitimin e qendrës Durrësit rast pas rasti tu shifte mundësia dhe në këto raste të tjera shpronësimi, tu merrte për bazë kush mund të ishin çmimet e referencë të shitjeve flas, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere në lidhje me pikën 3 i përgjigjem zotit Muka.

Zoti Muka doja të dija cila është vlera që ju nxirrni të saktë që mund të bëj krahasim si anëtare e këshillit dhe mund të gjej gabimin që ka bërë grupi i punës në nxjerrjen e kësaj vlere?

Dhe së dyti nëse do të ishte gabim kjo vlerë, çdo qytetar ka të drejtën t'i drejtohet dhe gjykatës. Por sot e kam me ju, jeni dhe ekspert dhe do doja të dija çfarë do të thotë vlerë objektivisht për ju? Cila tabelë do të merret parasyh për përcaktimin e një shifre të tillë nga grupi i punës? Faleminderit.

Ardian Muka: Do e marr unë apo...?

Ani Dyrmishi: Po z. Muka meqë tu përmend emri.

Ardian Muka: Atëhere eksperiencia edhe ligji është që dy janë mundësitë e shpronësimit ose çmimi i referencës, që është i deklaruar rasti besoj, i cili referohet dhe kjo që na ka sjellë bashkia rasti tjetër është kur merret për bazë çmimi i transaksioneve të tre muajve të fundit. Në këtë rast i drejtohet zyrave të AKSH-së ju vjen një shkresë, ju japin një çmim, unë nuk jam në brendësi të çmimit çfarë mund të jetë, sepse çmimi është pjesë e ndryshimit, ndyshon me ç'di unë me VKM, nga ana e qeverisë çdo tre muaj, pra bëhet rivlerësimi çdo tre muaj, por në fakt ato thonë duhet t'i referohet gjithmonë tregut të shitjeve që realizohet tre muaj e fundit.

Problemi im është i dyanshëm. E para më duket shumë pak dhe si akt 400 mijë lekë për aq shpronësime sa janë dhe kam hall mos është ndonë gabim material, por nëqoftëse është okey kjo pjesë atëhere unë do të preferoja që të ishte në këtë çmim. Nuk mund të them unë çmim, sepse sado specialist që jam, nuk merrem me këtë me pjesën e rivlerësimeve. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Zoti Jani kishe gjë për të thënë?

Elio Jani: Po. Faleminderit zoti kryetar.

Për sqarim për pjesën e pyetjeve që bënë këshilltarët, kryetarja e bashkisë ka ngrit një grup pune, në zbatim të saj, grupi i punës ka dalë me një material, sipas materialit i ka dalë vlera që kemi sot rreth 400 mijë lekë të reja, kjo nuk po flasim për pjesën e ndërtesave apo sipërfaqe ndërtimi që i jeni referuar, por flasim për pjesën e truallit që ka dal 400 mijë lekë të reja. Tani se pjesa është pak apo është shumë, këtë nuk e diskutojmë dot se kjo është në bazë të legjislacionit dhe bashkia e Durrësit zbaton vetëm ligjin. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Jani, atëhere koment tjetër ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra ?.....

Abstenim?.....

Atëhere me 39 vota Pro miratohet.

Ka ndonjë kundra?

Jonuz Myshketa: Po.

Ani Dyrmishi: Atëherë 39 pro, 1 kundra.

Faleminderit.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 4** i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere kryetar dhe pika 4 kalon për votim në Këshill, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave - Tarifave zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë kalon pikën 4 për miratim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 4, kemi?

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Është bërë procedurë normalisht kjo njihet si akt, por për mua ka shumë hije dyshimi, ka hije dyshimi përsa i takon pjesës së rialokimit të fondeve, pra meqenëse flasim për rikonstruksione ambientesh, rikonstruksione pallatesh dhe rikonstruksione të godinave publike, prona publike duke iu referuar VKM-ve të 2020, 2021, 2022, 23-it, 24-ës e kështu me radhë.

Unë e kuptoj që ato janë punime në proces dhe duke qenë punime në proces fondet trashëgohen, por flasim në 2025 për rialokime akoma të 2020, 2021, 2022, mund të kuptoja 2023, 2024 që janë godina që mund të kenë qenë në rikonstrukcion pallatesh që kërkojnë 1 apo 2 vjet që të përmbyllen, por të flasësh për rikonstruksione ambientesh të përbashkëta, pra për rikonstrukcion të pallateve të brendshme dhe kemi fondin, flasim për rreth 8 milion euro, për mua ka një hije dyshimi. Do të doja një përgjigje nga ana e bashkisë se si e justifikojnë këtë, pra rialokimi dhe kalimi i këtyre fondeve nga viti në vit me çfarë justifikimi është? Është thjesht pjesa që ato nuk kanë kryer, nuk kanë mbaruar akoma punë dhe për këtë trashëgohen nga viti në vit apo si është? Faleminderit.

Flutura Kasa: Kryetar, mundem.

Ani Dyrmishi: Po zonja Kasa.

Flutura Kasa: E kam për kundër-përgjigje të zotit Muka, por të jetë i sigurtë që shumica janë shtëpi individuale që marrin pjesën e dytë të fondit, shumica ke kjo pikë. Dhe e them me siguri absolute që nuk i përket fare pse është viti 2025, kaq kisha.

Ani Dyrmishi: Atëhere koment tjetër, ka?

Ardian Muka: Më falni.

Atëhere nëqoftëse shohim flitet për rikonstruksion, riparime banesa individuale bashkëpronësie të përbashkët, pastaj është rikonstruksion, ndërtim infrastrukturës publike, shembur ose të pabanueshme dëmtuar nga tërmeti, rikonstruksion, riparime banesash okej individuale akoma, shpronësi për zhvillimin e njësive të tërmetit, rikonstruksion të prapë godinave private. Pra shumica e fondit shkon për këtë që thotë zonja, por unë do doja nga ana e bashkisë një sqarim qoftë edhe për fondin për pjesën e dytë, kur del fondi, fondi duhet të dali për një pjesë, pse duhet fondi të shkojë me një, 2 apo 5 pjesë, kur flas për godinë private dihet kush është dëmi, është bërë rivlerësimi e ka pranuar që do ta ndërtojë vetë apo e merr përsipër firma, automatikisht çelet fondi dhe aty mbyllet. Këtu po të shohim ka dhe pjesë të tjera, që kanë lidhje me pjesën e ..., ëë jo më fal për pjesën e kolaudimit këto pastaj është çfarë parashikohet për 2025, ku do t'i çojmë neve, pra aprovimi që japim ne si bashki, por për pjesën e rikonstruksionit banesave private këtu është hija ime e dyshimit, pra kemi akoma nga 2020 godina private që nuk kanë mbaruar akoma procesin e rikonstruksionit, flasim për shtëpia normale një apo dy katëshe, duket që është e pajustificueshme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Ndoshta janë në proces, nuk kanë përfunduar, gjithësesi.

Po z. Jani.

Elio Jani: O zoti Muka ideja është këtu, rindërtimi nuk ka mbaruar akoma, jemi në proces të rindërtimit dhe shqyr kemi këto fonde që po ndihmojmë akoma qytetarët të mbarojnë shtëpiat. Nëqoftëse për ju është dyshim, për ne nuk është dyshim, për ne është praktikë pune kjo. Ne këtu vazhdojmë punën sipas detyrimeve që kemi secili, qeveria ka evakuuar fondet ne i kemi rialokuar sipas ligjit, është një gjë që njihet, bëhet vit për vit nuk është ndonjë risi kjo që bëjmë sot. Dhe besojmë dhe obligimi jonë është që të mbarojmë procesin e rindërtimit që qytetarët të futen në shtëpi kjo është, dyshimi juaj, me thënë të drejtën me gjithë respektin, nuk qëndron. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Dhe 2 minuta, zoti Muka.

Ardian Muka: Po faleminderit.

Zoti nënkryetar natyrisht që ne këtu jemi për të mbrojtur interesat e qytetarëve, jemi për zhvillimin, jemi për të mbyllur procesin e rindërtimit sa më shpejtë, por jemi edhe për të bërë dhe transparencë, prandaj është dhe ky organizëm. Juve jeni këtu për të dhënë përgjigje ndaj këtij institucioni. Them që nga 2020 në 2025 shpiat private, banesat private nuk duhet të ishin më. Pse? Janë kataloguar të gjithë, janë kataloguar të gjithë, nëqoftëse sot e kësaj dite pastaj dalin që akoma nuk kanë plotësuar letrat e tërmetit të 2019 në 2025 dhe çelet fondi për ato në 2025, këtu unë kam hijen e dyshimit.

Elio Jani: Është hija jote çfarë t'i bëjmë.

Ardian Muka: Tani pjesa tjetër

Mund të kërkojmë një komision pastaj të shohim pjesën e rialokimeve, pjesën e atyre çfarë është bërë, është pjesë që na takon neve, është e drejta e komisioneve është e drejta e anëtarëve.

E rëndësishme është besoj se këto fonde nuk do çelen përpara zgjedhjeve.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Muka.

Ardian Muka: Faleminderit .

Ani Dyrmishi: Po, z. Facja.

Lorenc Facja (*Drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike*): Përshëndetje !

Atëhere në lidhje me pretendimet apo sqarimet që kërkohen nga zoti Muka, në këtë pikë ne kemi kërkuar thjesht rialokim të fondeve, të cilat kanë qenë në 2024 dhe nuk është bërë likuidimi i kompanive, sepse kanë qenë në buxhetin e 2024 dhe prandaj po riallokohen në 2025, që të bëhet likuidimi i atyre punimeve që ka përfunduar. Dhe po ta shikosh këtu pjesa më e madhe janë kolaudim e mbikqyrje, që janë objekte të palikujduara nga ana e bashkisë. Nuk po flasim për objekte që kanë përfunduar apo nuk kanë përfunduar, sepse këto janë investime që kanë përfunduar nuk ka investime të papërfunduara. Thjesht është një rialokim domethënë nga buxheti 2024 në buxhetin e 2025 që ne të procedojmë me likuidimin e detyrimeve si bashki ndaj kompanive, të cilat kanë kryer punimet.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Facja.

Koment tjetër ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?.....3,4....7

Absenim?.....

33 pro 7 kundër; miratohet dhe pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 5**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zonjës Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi: Përshëndetje !

Edhe komisioni ynë me unanim votash vendosi që sot të kalojë në miratim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 5?

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Në relacionin që na keni përcjellur në pikën 1, kërkohet korrigjimi i tabelës nr.1 të shkollës 9 vjeçare, meqenëse për shkak të një gabimi ka ndodhur për shkak të volumit të madh të punë. Në pikën 2 kemi po të njëjtën problematikë, pra përfshihen nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Besnik Hidri”, gabimisht thuhet janë përfshirë disa nxënës nga lista e përfituesve dhe kërkohet heqja për 9 prej tyre, me të njëjtën justifikim dhe pika 3 për shkollën “Olsi Lasko”,

dhe “Bernardina Qeraxhi” për një peson, në ngarkesë të lartë të punës dhe gabim njerëzon në procesin e kategorizimit të të dhënave.

Kur fola për pikën 3 dhe diskutuam për problemin e atyre 400 mijë lekëve, mos kthehemi, prandaj thashë mos kthehemi siç po kthehemi për pikën 5, për gabime të mëdha njerëzore për ngarkesa të mëdha që paska pasur bashkia e Durrësit, kemi këto gabime që vijnë dhe t’i rikthehemi mbrapa. Ky ishte dhe motivi që ju referova dhe pikës 3. Faleminderit.

Ani Dymishi: Faleminderit, zoti Muka.

Koment tjetër ?....

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?.....1

Absenim?.....

Atëhere 40 pro, 1 kundra, atëhere miratohet pika 5 e rendit të ditës.

Duke qenë se dhe pyetje nga ana e këshilltarëve nuk janë paraqitur në Sekretari, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Për mbledhjen tjetër do të njoftoheni nga Sekretaria.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 9 (nëntë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Demokratike:

JONUZ MYSHKETA